

VENDIM
Nr. 55, datë 3.8.2009

PËR MIRATIMIN E KONTRATËS PËR FURNIZIMIN ME ENERGJI ELEKTRIKE
NDËRMJET SHOQËRISË KESH SHA (FURNIZUESI PUBLIK ME SHUMICË) DHE
SHOQËRISË OSSH SHA (FURNIZUESIT PUBLIK ME PAKICË) PËR PERIUDHËN
1.1.2009 DERI MË 31.12.2009

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar të neneve 111 dhe 112/2/b të Kodit të Procedurave Administrative, të miratuar me ligjin nr.8485, datë 12.5.1999, pikës 4.13 germa”A”, pika 2 të modelit të tregut të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.338, datë 19.3.2008, pikës V.1 të rregullave të tregut të energjisë elektrike, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.68, datë 23.6.2008, vendimit nr.22, datë 18.3.2009 “Për fillimin e procedurave të miratimit të kontratës së furnizimit midis KESH sh.a. dhe OSSH sh.a., Bordi i Komisionereve të Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 3.8.2009, pasi diskutoi mbi draftin e kontratës “Për furnizimin me energji elektrike ndërmjet shoqërisë KESH sh.a. (furnizuesi publik me shumicë) dhe shoqërisë OSSH sh.a. (furnizuesit publik me pakicë) për periudhën 1.1.2009 deri më 31.12.2009”,

konstatoi se:

- Kontrata është lidhur nga KESH sh.a. dhe OSSH sh.a., subjekte të licencuara nga ERE-ja, përkatësisht me vendimet nr.11, datë 23.6.2006 dhe nr.9, datë 25.1.2008, të ndryshuar.

- Modeli i tregut të energjisë elektrike dhe rregullat e tregut të energjisë elektrike përcaktojnë se kjo kontratë i nënshtrohet tregut të rregulluar.

- Në referencë të akteve të sipërcituara, ERE-ja është autoriteti i përcaktuar për miratimin e kësaj kontratate.

Për sa më sipërevidentuar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës për furnizimin me energji elektrike ndërmjet shoqërisë KESH sh.a. (furnizuesi publik me shumicë) dhe shoqërisë OSSH sh.a. (furnizuesit publik me pakicë) për periudhën 1.1.2009 deri më 31.12.2009 me ndryshimin në nenin 8, pika 1, si më poshtë:

Neni 8 pika 1

Pas fjalës “një shumë” të shtohet paragrafi: të barabartë më kostot/shpenzimet shtesë, të arsyeshme, të argumentuara dhe të verifikueshme që pëson pala pranuese furnizues publik me pakicë (FPP), si pasojë e paaftësisë për livrim energjie elektrike te konsumatorët tariforë.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë KESH-in dhe OSSH-në për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s dhe ndjekjen e mëtejshme të procedurave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta